

VENDIM
Nr. 704, datë 18.11.2021

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR. 162, DATË 2.3.2016, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR RREGULLAT, PROCEDURAT DHE MËNYRAT E VËNIES
NË DISPOZICION TË PASURIVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE NË
ZONAT ME PËRPARËSI ZHVILLIMIN E TURIZMIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 35, të ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 162, datë 2.3.2016, të Këshillit të Ministrave, pas pikës 4, të kreut I, shtohen pikat 4.1 dhe 4.2, me këtë përmbajtje:

“4.1 Në rastin e investitorëve strategjikë, sipas ligjit nr. 55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nuk zbatohet procedura e përcaktuar në kreun II, të këtij vendimi, për vënien në dispozicion të pasurive të paluajtshme shtetërore, në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit. Vënia në dispozicion e këtyre pasurive bëhet, si më poshtë vijon:

a) Komiteti i Investimeve Strategjike (KIS) miraton paraprakisht vënien në dispozicion të pasurive të paluajtshme shtetërore, në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit për investitorët strategjikë, si masë mbështetëse për realizimin e investimit, në përputhje me ligjin nr. 55/2015, të ndryshuar.

b) Vendimi i KIS-it dhe dokumentacioni shoqërues i përcillen ministrisë përgjegjëse për turizmin nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve.

4.2 Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për turizmin, miraton vënien në dispozicion të pasurive të paluajtshme shtetërore, sipas pikës 4.1, të kreut I, të këtij vendimi.”.

2. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama